

SYLLABUS

E DREJTA FAMILJARE DHE TRASHËGIMORE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E drejta familjare dhe trashëgimore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i dytë, Semestri Veror
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr. Ardit Gashi
Detajet kontaktuese:	E-mail: ardrit.gashi@uni-pr.edu Konsultimet: <i>E martë ora 10:00 – 12:00;</i> <i>E enjte ora 14:00 – 16:00 .</i>
Përshkrimi i lëndës:	<p>E drejta familjare paraqet degën më të vjetër të së drejtës private.</p> <p>Termi <i>E drejtë familjare</i> nganjëherë përdorët për të emërtuar degën e së drejtës në kuadër të sistemit juridik të një vendi, dhe nganjëherë përdorët për emërtimin e disiplinës shkencore në kuadër të shkencave juridike.</p> <p>E drejta familjare si degë e së drejtës rregullon familjen dhe marrëdhëniet personale juridike që lindin familja. Ndërsa, ‘familja’ nënkupton bashkësinë vitale të prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave tjerë në gjini. Kjo bashkësi mund të jetë bashkësi e personave të lidhur nga gjaku, ose me ligj, veçanërisht brenda dy apo tre brezave. Në kuptim me të gjerë, familja mund të paraqet një grup personash që jetojnë së bashku dhe kanë një angazhim (zotim) të përbashkët për një marrëdhënie familjare. Pastaj, varësisht nga ajo se si themelohet bashkësia e personave në familje, hasen edhe nocionet familje martesore, jashtëmartesore, e adoptimit. Apo, varësisht nga numri i personave - brezave që jetojnë bashkërisht, hasen edhe nocionet familje e madhe, familje e vogël.</p> <p>Marrëdhëniet juridike që lindin nga familja gjithashtu mund të ndryshme duke filluar nga fejesa si premtim i dy personave për lidhjen e martesës, martesën, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet pasurore në</p>

	<p>familje, marrëdhëniet në bashkësinë jashtëmartesore, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, format e mbrojtës së veçantë të fëmijëve, marrëdhëniet e adoptimit, kujdestarisë dhe marrëdhëniet nga vendosja e fëmijëve në familjen tjetër.</p> <p>E drejta familjare si disiplinë shkencore, nënkupton tërësinë e studimeve mbi marrëdhëniet familjare dhe martesore si dhe marrëdhëniet tjera që lindin nga to.</p> <p>E drejta trashëgimore është tërësia e normave të cilat rregullojnë marrëdhëniet juridike në rast të vdekjes së personit fizik (<i>mortis causa</i>) përkatësisht në rastin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe realizimi i trashëgimit nga personat pasjetues–të quajtur trashëgimtarë.</p> <p>E drejta trashëgimore si degë e së drejtës përmes dispozitave ligjore rregullon në hollësi bazën juridike për thirrje në trashëgimi, radhën e personave të cilat janë legjitim për gëzimin e pasurisë trashëgimore, mënyrën e ndarjes të pasurisë të pasurisë trashëgimore, etj.</p> <p>Sikurse E drejta familjare, ashtu edhe E drejta trashëgimore në Kosovë janë të rregulluara me ligje të veçanta. Ndërsa në disa vende ku e drejta civile është e rregulluar me kod civile atëherë këto janë të rregulluara me pjese të veçanta apo Libra të veçantë</p> <p>Si disiplinë shkencore, e drejta trashëgimore përfshinë tërësinë e studimeve me të cilat studiohen normat juridike dhe raportet në rastet e trashëgimit.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Qëllimi kryesor i lëndës është që studentëve të ju ofrohen njohuri dhe përgatitje e nevojshme profesionale lidhur me nocionet dhe institutet bazike të së drejtës familjare dhe trashëgimore. Duke filluar nga familja dhe të gjitha marrëdhëniet që dalin nga familja. Në këto marrëdhënie juridike, përfshihen një varg i të drejtash dhe detyrimesh, të cilat mund të jenë të karakterit personal juridik dhe pasuror juridik.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Studentët do të fitojnë njohuri thelbësore teorike lidhur me lëndën dhe institutet juridike të së drejtës familjare dhe trashëgimore.</p> <p>Studentët do të kenë të qartë vendin e të drejtës familjare dhe trashëgimore në sistemin juridik.</p> <p>Studentët do të fitojnë njohuri të mjaftueshme lidhur me marrëdhëniet juridike familjare, trashëgimore dhe dallimin e tyre nga marrëdhëniet juridike civile në përgjithësi, rrjedhimisht të kenë të qartë aplikimin e mirëfilltë të normave juridike adekuate për situatat faktike.</p> <p>Studentët do të jenë në gjendje që të kuptojnë drejtë dhe identifikojnë kur kemi të bëjmë me një marrëdhënie juridike pasurore familjare dhe marrëdhënie juridike personale familjare dhe kur jemi të aftë të krijojmë marrëdhëniet e tilla.</p> <p>Do të kuptojnë rastet dhe situatat se si mund të zgjidhen dhe adresohen konfliktet apo kontestet në kuadër të së drejtës familjare dhe trashëgimore.</p> <p>Studentët do të kenë të qartë po ashtu procedurat civile të cilat mund të zhvillohen në rast cenimit të drejtave nga marrëdhëniet juridike familjare dhe trashëgimore, dhe mbi bazën e cilave normave juridike të procedurës civile.</p> <p>Studentët me marrjen e njohurive nga kjo lëndë, do të kenë mundësi që përmes metodave të interpretimit juridik dhe qasjes analitike t'i zgjedhin detyrat të cilat kërkohen në fushën e së drejtës familjare dhe trashëgimore.</p> <p>Studentët do të mund të fitojnë dhe zhvillojnë edhe shkathtësitë e tyre për qasje kritike për ligjin dhe argumentimin ligjor në fushën e së drejtës familjare dhe trashëgimore.</p>
---	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	Javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	Javë	15
Punë praktike	/	/	/

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	Javë	/
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume, seminare	2		
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	/	/	/
Përgatitja përfundimtare për provim	3	30 ditë	90
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet, etj.	1	15 Ditë	15
Totali	30	15 Javë	150

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjëratat do të ofrohen sipas metodave dhe standardeve me të avancuara në fushën e studimeve të së drejtës. Si e metoda bazike apo themelore do të jenë metoda ligjërimit, metoda interaktive, metoda e studimit të rasteve praktike dhe metoda analitike juridike.

Metoda e ligjërimit do të mundësoj që studentët marrin njohuritë drejtpërdrejt nga lënda e të drejtës familjare dhe trashëgimore. Ligjërimit do të përfshijë një trajtim dhe diskutim të gjerë teorik doktrinar dhe praktik për të gjitha temat nga e drejta familjare dhe trashëgimore.

Përmes metodës interaktive synohet një aktivitet si nga ana e mësimdhënësit ashtu edhe të studentëve, do të krijoj mundësi që edhe studentet të paraqesin pikëpamjet dhe botëkuptimin e tyre lidhur me të drejtën familjare dhe trashëgimore. Në këtë kuptim do të praktikohen edhe punimet seminarike, dhe prezantimet. Studentët do të inkurajohen për studimin e ndonjë teme apo instituti juridik dhe paraqitjen e rezultateve të studimit në formën e punimit seminarik apo prezantimit.

Metoda e studimit të rasteve praktike dhe metoda analitike, po ashtu paraqet një rëndësi të posaçme sidomos për lëndën e të drejtës familjare dhe trashëgimore. Rastet praktike dhe shembujt nga praktika juridike do të mundësojnë që studentët të arrijnë një shkallë me të gjerë të zhvillimit të aftësive të tyre në interpretimin e ligjit dhe metodat për interpretimin e ligjit. Përmes kësaj metode, në instancën e fundit studentet do të jenë në gjendje që të analizojnë normat juridike relevante për marrëdhëniet juridike familjare.

	<p>Ushtrimet janë pjesë e mësimit nga e drejta familjare dhe trashëgimore, përmes të cilave studentët do të mësojnë më shumë rreth zbatimit praktik të së drejtës familjare dhe trashëgimore.</p>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi i studentit do të bazohet në gjithë aktivitetin dhe angazhimin e tij hulumtues dhe didaktik, si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Vijueshmëria në ligjërata dhe diskutimet në klasë – 10%;</i> 2. <i>Punimi seminarik dhe prezantimi – 10%-20%;</i> 3. <i>Testi I (kollokçiumi I) – 35%</i> 4. <i>Testi II (kollokçiumi II) – 35%</i> <p><i>Për të kaluar provimin nevojiten së paku 55 pikë. 55- 64 pikë/nota 6; 65-74 pikë/nota 7; 75-84 pikë/nota 8; 85-94 pikë/nota 9; 95-100/nota 10</i></p>
Literatura	
<p>Literatura bazë:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Abdulla Aliu & Haxhi Gashi, <i>E Drejta Familjare</i>, Prishtinë, 2007. - Hamdi Podvorica, <i>E Drejta Familjare</i>, Prishtinë, 2011. - Bedri Bahtiri, <i>Aspektet nacionale dhe ndërkombëtare të regjimit pasuror martesor të bashkëshortëve</i>, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2018. - Bedri Bahtiri & Asllan Bilalli, <i>E Drejta Trashëgimore</i>, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2021. - Ardit Gashi, Avni Puka, Iset Morina, Nebojša Boričić, Visar Morina, <i>FJALOR JURIDIK – E drejta private, publike dhe penale</i>, Iset Morina (ed.), Prishtinë, 2019; - Ligji për familjen me ndryshime; - Ligji për trashëgiminë me ndryshime; - Ligji për noterinë; - Ligji për procedurën jokontestimore me ndryshime.

Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Arta Mandro, <i>E drejta familjare</i>, Tiranë, 2009 - Sonila Omari, <i>E drejta familjare</i>, 2010 - Arta Mandro-Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Ariana Fullani, <i>E drejta familjare</i>, Tiranë, 2006 - Aleks Laurasi, <i>Marrëdhëniet familjare</i>, Laurasi, Tiranë, 2001 - Valentina Zaçe, <i>Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar</i>, Tiranë, 1999 - Santhipi Begeja, <i>E drejta familjare e Shqipërisë</i>, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë - Leslie J.Harris & Lee E, Teitelbaum, <i>Family Law</i>, Aspen Law & Business, New York, 2000 - D. Kelly Weisberg & Susan Frelich Appleton, <i>Modern Family Law- cases and materials</i>, Aspen Law & Business, New York, 1998. - M.Alinčić- A.Abramović- D. Hrabar – J-Lozić – A, Korać, <i>Obiteljsko Pravo, Narodne Novine</i>, Zagreb, 2001. - Juliana Latifi, <i>E drejta e trashëgimisë në Kosovë</i>, Prishtinë 2010. - Francesko Galgano, <i>E drejta private</i>, Luarasi, 2003
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Javët	
Java e parë:	<ul style="list-style-type: none"> - Nocioni dhe emërtimi i të drejtës familjare, objekti i të drejtës familjare - Metodrat e studimit të së drejtës familjare, parimet themelore të së drejtës familjare - Burimet e së drejtës familjare - Marrëdhëniet e së drejtës familjare me disiplinat tjera shkencore
Java e dytë:	<ul style="list-style-type: none"> - Nocioni i familjes - Llojet e familjes - Funksionet e familjes - Struktura e lidhjeve familjare (gjinia e gjakut, gjinia e krushqisë, gjinia e adoptimit)
Java e tretë:	<ul style="list-style-type: none"> - Hyrje në të drejtën martesore dhe kuptimi i saj - Objekti i të drejtës martesore - Subjektet e të drejtës martesore - Parimet themelore të të drejtës martesore - Fejesa - Martesa dhe kuptimi i saj - Qëllimet martesore - Kushtet për lidhjen e martesës - Pengesat martesore - Ndalesat martesore - Kushtet formale për lidhjen e martesës - Procedura paraprake - Lidhja e martesës
Java e katërt:	<ul style="list-style-type: none"> - Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve - Zgjidhja e martesës, mënyrat, shkaqet dhe procedura e

	<p>shkurorëzimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasojat juridike të zgjidhjes së martesës - Bashkësia jashtëmartesore si dukuri shoqërore - Efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesore
Java e pestë:	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve - Subjektet e të drejtës prindërore - Legjitimimi i fëmijëve, statusi i fëmijëve martesor, statusi i fëmijëve jashtëmartesor - Kundërshtimi i amësisë dhe kundërshtimi i atësisë - Procedurat e kundërshtimi të amësisë dhe atësisë - Njohja e amësisë dhe e atësisë - Vërtetimi i amësisë dhe atësisë me vendim të gjykatës - E drejta prindërore (kuptimi dhe objekti) - Marrëdhëniet personale dhe pasurore mes prindërve dhe fëmijëve - Ushtrimi i të drejtës prindërore - Pezullimi, kufizimi, heqja dhe vazhdimi dhe mbarimi i të drejtës prindërore
Java e gjashtë:	<ul style="list-style-type: none"> - Adoptimi / birësimi - Procedurat e themelimit të adoptimit, efektet juridike të adoptimit - Vendosja e organizuar e fëmijës në familjen tjetër për përkujdesje - Detyrimet e ushqimit (mbajtja financiar) - Personat e detyruar për dhënien e ushqimit - Kushtet për dhënien e ushqimi
Java e shtatë:	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhëniet pasurore - Regjimi i kontraktimit - E drejta e kujdestarisë - Personat nënë kujdestari - Kujdestaria ndaj fëmijëve të mitur - Kujdestaria ndaj personave me pazotësi të veprimit (zotësi të hequr të veprimit) - Rastet e veçanta të kujdestarisë - Rastet e veçanta të kujdestarisë kur nuk janë përcaktuar me dispozita ligjore - Pushimi i kujdestarisë
Java e tetë:	Provimi i ndërmjetëm (Kollokfiumi i I)
Java e nëntë:	<ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia, e drejta trashëgimore, nocioni dhe emërtimi i të drejtës trashëgimore - Kuptimi objektiv dhe subjektiv i të drejtës trashëgimore - Rëndësia dhe qëllimet e të drejtës trashëgimore - Natyra juridike e trashëgimisë - Zhvillimi historik i trashëgimisë - E drejta trashëgimore në formacionin skllavopronar - E drejta trashëgimore në feudalizëm - E drejta trashëgimore në kapitalizëm, socializëm dhe në periudhën më të re - Burimet e të drejtës trashëgimore
Java e dhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia si suksesion univerzal dhe singular - Kushtet themelore për krijimin e marrëdhënieve juridike

	<ul style="list-style-type: none"> trashëgimore - Nocioni i trashëgimisë; - Përmbajtja e trashëgimisë - Konstatimi i trashëgimisë - Pasuria që veçohet nga pasuria trashëgimore - Përcaktimi i vlerës së trashëgimisë - Trashëgimtarët - Personat fizik si trashëgimtarë - Zotësia për të trashëguar - Paaftësia për të trashëguar - Padenjësia për të trashëguar - Arsyet për padenjësi për të trashëguar - Mënyra e konstatimit të padenjje për të trashëguar - Bazat për tu thirrur në trashëgimi - Ligji - Testamenti - Kontrata mbi trashëgiminë
Java e njëmbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Parimet themelore të të drejtës trashëgimore - Parimi i suksesionit universal - Parimi i ndalimit të kontratës si bazë për trashëgim - Parimi i kufizimit të disponimit me testament - Parimi i fitimit të trashëgimisë sipas fuqisë ligjore - Parimi i përgjegjesisë së kufizuar të trashëgimisë - Parimi i ofcialitetit të shqyrtimit gjyqësor të trashëgimisë - Trashëgimia ligjore - Kuptimi dhe rëndësia e trashëgimisë ligjore - Faktet vendimtare gjatë formimit të rrethit të trashëgimisë ligjore - Gjinia dhe trashëgimia ligjore - Bashkëshortësia (ligjore bashkëshortore) dhe trashëgimia ligjore - Faktet (rrethanat) tjera që ndikojnë në trashëgiminë ligjore - Grupimi i trashëgimisë ligjore radhët trashëgimore - <i>Sistemi i afërsisë së gjinisë</i> - <i>Sistemi i gjakut të përbashkët</i> - <i>Sistemi i parentelëve</i>
Java e dymbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - E drejta e përfaqësimit dhe e drejta e shtimit - Trashëgimia ligjore në Republikën e Kosovës - Rrethi i trashëgimtarëve ligjor - Radhët trashëgimore - <i>Radha e parë e trashëgimisë</i> - <i>Radha e dytë trashëgimore</i> - <i>Radha e tretë e trashëgimisë</i>
Java e trembëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesa e domosdoshme (e domosdoshme) dhe trashëgimia e domosdoshme - Nocioni dhe rëndësia e pjesës së domosdoshme ligjore - Pjesa e domosdoshme - Rrethi i trashëgimisë së domosdoshme - Madhësia dhe llogaritja e pjesës së domosdoshme - Cenimi dhe të siguruarit e pjesës së domosdoshme - Përjashtimi dhe privimi nga e drejta në pjesë të

	<p>domosdoshme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfashtimi nga trashëgimia - Shpallja e trashëgimisë pa trashëgimtar si pronë publike - Trashëgimia sipas testamentit - Kuptimi dhe parimet e procedurës së shqyrtimit të trashëgimisë - Aktvendimi për trashëgimi
Java e katërbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> - Kontrata për cedimin dhe ndarjen e pasurisë për së gjalli - Kontrata për mbajtje të përjetshme - Procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore - Shqyrtimi trashëgimor në procedurën gjyqësore dhe noteriale - Dërgimi në kontest ose në procedurë tjetër - Aktvendimi për trashëgiminë - Procedura për rastin kur është kompetent organi i shtetit të huaj - Mjetet juridike në procedurën trashëgimore - Mjetet e rregullta të goditjes së vendimit - Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes së vendimit
Java e pesëmbëdhjetë:	Provimi i ndërmjetëm (Kollokiumi i II)
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Studentët janë të obliguar që të vijnë ligjëratat, ushtrimet si dhe të gjitha aktivitetet gjatë gjithë semestrit, e gjithashtu duhet tu përmbahen dispozitave të Statutit dhe Kodit të Etikës.</p>	